



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026**  
**Mitrovicë**

02-060/01-0014451-7/26  
27.03.2026  
Opština Juzna Mitrovica

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 17 pika g, pika j, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008); në nenin 37, 57, 90 dhe 91 të Ligjit Nr. 04/L-027 Për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 22/2011); nenet 12, 29, 30, dhe 31 të Rregullores Nr. 17/2015 Për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 27.03.2026, pasi shqyrtoi Raportin mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-00013479-6/26 dt. 17.03.2026), sjell këtë:

#### VENDIM

**Për miratimin e Raportit mbi vlerësimin e dëmeve në ekonomi familjare dhe në bujqësi si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026**

1. MIRATOHET Raporti mbi vlerësimin e dëmeve në Ekonomi Familjare dhe dëmeve në bujqësi si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti mbi vlerësimin e dëmeve në ekonomi familjare dhe dëmeve në bujqësi si pasojë e vërshimeve të ndodhura në muajin janar 2026 në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut
3. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit  
1 x 1 MAPL-së  
1 x 1 Arkivit  
Kopje: Kryetarit të Komunës